



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2021:081915
Datë: 22.03.2024
Numri i dokumentit: 05493672

C.nr.353/24

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA VUSHTRRI - si kontestimore e përbërë nga gjyqtari Izet Gërguri, në çështjen juridike të paditëses K.K nga Vushtrria, të cilën e përfaqëson av.H.K nga Drenasi, kundër të të paditurës B... me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson D.S në Kompaninë D..., me adresë rr..., lidhur me kompensim dëm, vlera e kontestit 15,550 euro, duke rivendosur në rigjykim sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2974/21 të datës 15.01.2024, pas mbajtjesë së shqyrtimit kryesor verbal e publik të datës 14.03.2024, jashtë seance, me datën 22.03.2024, e mori dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkespadija e paditëses K.K nga Vushtrria, kundër të të paditurës B... me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit në lartësi prej 15,550 euro, ashtu që DETYROHET e paditura B... me seli në Prishtinë, që paditëses K.K nga Vushtrria, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material, për shkak të lëndimeve të marra në aksidentin e komunikacionit të datës 13.09.2010, (me lëshime sekondare në shkaktimin e aksidentit në shkallë prej 20 % për paditësen dhe me lëshime primare prej 80% për të paditurën), t'ia kompensoj shumat dhe kategoritë si në vijim:

1. Në emër të dhimbjeve fizike dhe trupore të përjetuara shumën e përgjithshme prej 2800, euro,
2. Në emër të frikën së përjetuar, shumën prej 2400 euro,
3. Në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvoglimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor (thyerje të hundës dhe mbylljes së pjesërishtme të njëjës vrimë 3%) të pësuar në shkallën prej 5.91%, shumën prej 2800 e uro,
4. Në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 2400 euro,
5. Në emër të kujdesit dhe ndihmës nga personi tjetër për 35 ditë, shumën prej 280 euro,
6. Në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 245 euro,
7. Në emër të shpenzimeve të shërimit, shumën prej 1200 euro,

Pra në shumë të përgjithshme për të gjitha kategoritë e lartcekura prej 12,125 euro, me kamatëvonesë si për mjetet e depozituara për një vit, pa destinim të caktuar, duke llogaritur nga data 12.06.2015 e gjerë në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi të përgjithshme prej 2030,40 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm,

II.REFUZOHET pjesërisht si e pa bazuar kërkespadija e K.K nga Vushtrria, kundër të të paditurës B... me seli në Prishtinë, lidhur me kompensim dëmi dhe atë përtej shumave dhe kategorive të njohura si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike të përjetuara, shumën prej 700 euro, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 600 euro, në emër të zvoglimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 700 euro, në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 600 euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 105 euro, për kujdes dhe ndihmë nga personi tjetër për 35 ditë, shumën prej 70 euro, për shërim

klimaterik – fiziterapeutik shumen prej 350 euro, në emër të shpenzimeve të shërimit shumen prej 300 euro, gjithsej të refuzuara në lartësi të përgjithshme prej 3425 euro.

A r s y e t i m

Paditësja K.K nga Vushtrria, përmes padisë së paraqitur pranë kësaj gjykate me datën 09.03.2011, ka kërkuar nga gjykata që të obligohet e paditura që në emër të zhdëmtimit material dhe jo material, e paditura të paguaj shumën e përgjithshme pas precizimit të lartësisë së kërkesës së saj, prej 15,550 euro, ndërsa ka propozuar që në bazë të kontributit të ndarë në shkaktimin e aksidentit ti aprovohet lartësia e kërkesëpadisë të paktën në shumën prej 8864 euro, për shkak të akidentit fatkeqësisë së komunikacionit e cila ka ndodhur me datën 13.09.2010, në magjistralen Prishtinë-Mitrovicë, në rrugën ..., përballë marketit A..., me c'rast paditësja K.K ka pësuar lëndime të rënda trupore, të shkaktuara si pasojë e goditjes nga automjeti i markes Ford-Gaf, ngjyrë hiri, me targa të regjistrimit ..., pronë e personit N.O nga Vushtrria, pa regjistrim të rregullt dhe pa afat sigurimi, të cilën e drejtonte ngasësi I.N nga Vushtrria, e cili duke mos e përshtat shpejtësinë e lëvizjes e godet biciklisten- paditësen, duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore. Gjykata në riprocedurë, për herë të tretë, sipas aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.2974/21 të datës 15.01.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor të datës 14.03.2024 në të cilën morën pjesë përfaqësuesi i paditëses av.H.K dhe përfaqësuesja e të paditues D.S.

Përfaqësuesi i paditëses av.H.K gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar, e të cilën e ka precizuar me parashtrësen e dorëzuar në gjykatë me datën 14.03.2024, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar ashtu që të detyrohet e paditura që paditëses, të ia kompensoj shumat dhe për kategoritë si në vijim: në emër të dhimbjeve fizike dhe trupore të përjetuara shumën e përgjithshme prej 3500, euro, në emër të frikën së përjetuar, shumën prej 3000 euro, në emër të dhimbjeve shpirtërore për zvoglimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor (thyerje të hundës dhe mbylljes së pjesërishme të njërës vrimë 3%) të pësuar në shkallën prej 5.91%, shumën prej 3500 euro, në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 3000 euro, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 350 euro, për kujdes dhe ndihmë nga personi tjetër për 35 ditë, shumën prej 350 euro, për shërim klimaterik – fiziterapeutik shumen prej 350 euro, shpenzime të mjekimit shumën prej 1500 euro, në shumë të përgjithshme prej 15.550 euro mirëpo ka propozuar që marrë parasysh shkallën e kontributit të paditëses prej 20 % në shkaktimin e aksidentit, ti zbritet shuma prej 20 % e shumës së përgjithshme dhe paditëses ti kompensohet shuma për të gjitha kategoritë prej 12,440 euro, si dhe në emër të shpenzimeve të procedurës në lartësi të përgjithshme prej 2538 euro.

Përfaqësuesja e të paditues D.S gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e precizuar të paditëses, duke i propozuar gjykatës ndër të tjera që me rastin e vendosjes të ketë parasysh ndarjen e përgjegjësisë dhe atë me 70 me 30 % për paditësen meqenëse të njëjtat janë edhe udhëzim i Gjykatës së Apelit dhe se përtej shumës së ofruar nga e paditura ta refuzoj si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses e po ashtu sa u përket shpenzimeve të procedurës të mirret parasysh suksesi në procedurë. Ka kundërshtuar edhe kërkesën për kamatë dhe lartësinë e saj. Pra e paditura nuk e ka kundërshtuar ndarjen e përgjegjësisë lidhur me shkaktimin e aksidentit, ndërsa ka propozuar që ndarja e përgjegjësisë të jetë 30% me 70 % e jo 20% me 80% sic ka pretenduar pala paditëse. Njëherit në këtë çështje kontestimore i ka ofruar paditëses shumën prej 3000 euro në emër të arritjes së marrëveshjes gjyqësore për kompensimin e të gjitha formave të ompensimit të dëmit për paditësen duke përfshirë edhe shpenzimet e procedurës, duke mos përfshirë edhe shpenzimet për ekspertizë mjekësore të kryer nga eksperti dr.M.H.

Pala paditëse nuk e ka pranuar ofertën e të paditues për lidhjen e marrëveshjes gjyqësore në këtë çështje juridike.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike në këtë çështje juridike ka bërë leximin dhe administrimin e provave materiale si: përgjigjën në padi të të paditurës të datës 26.03.2015, fletëleshimin në emër të paditëses nr.i historisë 270/10, i lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale dhe orale, vendimin e të paditëses të datës 11.02.2011, raportin e aksidentit të datës 13.09.2010, së bashku me skicen e vendit të ngjarjes, raportet mjekësore në emër të paditëses, ekspertizën e ekspertit të komunikacionit R.B të datës 07.07.2020, ekspertizën mjekësore të ekspertit dr.M.H të datës 22.08.2020, mendimin dhe konstatimin e dhënë nga neuropsikiatër M.K në procesverbalin e datës 06.05.2015, mendimin dhe konstatimin e ekspertit ortoped traumatolog dr.A.Xh të dhënë në procesverbalin e datës 06.05.2015, ekspertizën e ekspertit ortoped traumatolog dr.M.H si dhe ekspertizën e komunikacionit të ekspertit ing.S.B të datës 08.01.2021, raportin e epikrezes i lëshuar nga Spitali Amerikan në Prishtinë në emër të paditëses me datën 28.09.2023, fatura e lëshuar nga Spitali Amerikan në Prishtinë, i datës 27.09.2023 dhe ka vështruar fotodokumentacionin në shkresat e lëndës.

Në bazë të raportit policor të datës 13.09.2010 vërtetohet se me datën 13.09.2010, deri tek aksidenti ka ardh kur ngasësi ilartcekur, I.N nga Vushtrria, me automjetin i tipit "FORD GAF", ngjyrë hiri me targa të regjistrimit ... pa regjistrim dhe pa sigurim të rregullt duke mos e përshtatur shpejtësinë e lëvizjes me kushtet e rrugës që ta ndaloj automjetin para çdo pengesë,ku me pjesën e përparme të pjesës së djathtë e godet K.K që gjendej në biçikletë e cila kishte dalë nga një rugicë nga ana e djathtë për të kaluar rrugën ku me këtë rast nga përplasja i shkakton lëndime trupore dhe se automjeti "FORD –GAF" ka qenë pa regjistrim të rregullt dhe i pa siguruar.

Nga fletëleshimi në emër të paditëses nr.i historisë 270/10, i lëshuar nga Klinika e Kirurgjisë Maksillofaciale dhe Orale vërtetohet se paditësja në këtë klinikë është mjekuar nga data 14.09-21.09.2010.

Me vendimin e të paditëses së datës 11.02.2011, I ka aprovuar kërkesën e paditëses për zhdëmtim të dëmit jo material të pësuar në aksident, në vlerë prej 2975 euro si dhe shpenzimet e avokatit prej 179 euro.

Në bazë të ekspertizës mjekësore – mendimit dhe konstatimit të dhënë nga eksperti psikiatër M.K, psikiatër në Klinikën e Psikiatrisë në Prishtinë, drejtëpërsëdrejti në seancën gjyqësore të datës 06.05.2015, vërtetohet se paditësja me rastin e aksidentit ka përjetuar frikë primare, në momentin e aksidentit ka qenë duke përjetuar në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimi direct për integritetin e saj fizik, që ka zgjat disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatë afër 10 ditë e manifestuar me frikë, zgjime të herë pas-hershme gjatë natës me rikujtim të ngjarjes traumatike, crregullim të gjumit, crregullim të disponimit e që nënkupton regaimin akut të stresit, e kjo frikë është kaluar në frikë sekondare me intensitet më të ultë, që ka zgjatur rreth 5 muaj dhe është shoqëruar me reagime emocionale të karakterit ankciroz, crregullim të gjumit, lodhje e shpejtë, rënie e aktivitetit, rënie e vëmendjes dhe koncentrimit, rënie e vullnetit dhe disponimit, rënie e suksesit dhe intensitetit në mësim, për cka ka kërkuar edhe ndihmen e psikiatrit për fëmijë, disa herë që është trajtuar nga ajo në disa seanca psikoterapeutike, se frikë dhe pa siguri ndjen edhe sot herë pas here gjatë kalimit të rrugës.

Në bazë të ekspertizës mjekësore-mendimit dhe konstatimit të dhënë në seancën gjyqësore të datës 06.05.2015, nga eksperti ortoped-traumatolog dr.A.Xh i njëjti ka dhënë mendimin dhe konstatimin e tij se paditësja me rastin e aksidentit ka pësuar ndrydhje koke dhe fytyre, ndrydhje në regjionin e buzës së sipërme në anën e majtë si dhe ndrydhje të fytyres, thyerje të hundës pa dislokim (mungon RTG), dhe se këto lëndime bëjnë pjesë në lëndime të lehta trupore e të cilat kanë shkaktuar dhimbje fizike me intenzitet posaqërisht të rëndë nuk ka, me intenzitet të rëndë 3 orë, nga momenti aksidentit deri në dërgimin në QKUK si dhe mbarimin e ekzaminimeve mjekësore, dhimbje të intensitetit të mesëm për 10 ditë, të intensitetit të lehtë për 2 muaj nga data e lëndimit, shëmtim trupor të nivelit të lehtë trupor në nivel të faqës së majtë të dukshme, zvogëlim të aktivitetit jetësor nuk ka, ndihmë nga personi tjetër nuk ka pas nevojë, rehabilitim nuk ka pas nevojë ndërsa ushim të përforcuar për 1 muaj,

Në bazë të ekspertizën së ekspertit të komunikacionit R.B të datës 07.07.2020 gjykata nuk ka mundur ta vërtetoj sakt se aksidenti me lëshimet e ciles palë është shkaktuar pasi i njëjti në konstatimin dhe mendimin e tij ka cekur se; “duke pasur paraysh shumë mangësi të cekura (prova) në këtë material të ofruar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë- Dega në Vushtrri është e vështirë të jepet mendim i prerë në lidhje me kontributin e shkaktimit të aksidentit për secilin nga pjesmarrësit e përfshirë në aksident, mirëpo bazuar në këtë material dhe pas analizimit në detaje të këtij materiali ka konstatuar se kontributë në këtë aksident të trafikut ka pasur nga ana e ngasësit I.N me automjetin “A” për arsye se nga pakujdesia nuk ju ka kushtuar kujdes të duhur pjesmarrësve në komunikacion, e me këtë rast nuk ka pasur kujdes të duhur ndaj biçiklistes “B” K.K, si dhe nuk ja ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes kushteve të krijuara në komunikacion dhe në momentin kur ju ka paraqitur rreziku nga aksidenti ngasësi i cekur më lart nuk ka mundur ta ndal automjetin me kohë para çdo pengese që ju ka paraqitur në rrugë, me ç’rast me pjesën e përparë të djalhtë e ka goditur biçiklisten K.K duke i shkaktuar lëndime trupore, dhe me këtë rast shkaktohet aksident trafiku me lëndime trupore në njerëz dhe me dëme material në biçikleten “B”, , pra nuk ka specifikuar se edhe paditësja a ka pasur lëshime në shkaktimin e aksidentit apo jo dhe nëse po dhe në çfarë shkalle të lëshimeve primare apo sekondare, e për këtë arsye gjykata me propozimin e palës së paditur në këtë çështje juridike ka caktuar ekspertizën e dytë të komunikacionit të cilen e ka kryer eksperti S.B i cili e ka specifikuar në detaje se drejtuesi i automjetit A) I.N, Auto: FORD (BKS), është shkaktar i aksidentit (primar) kurse paditësja B) me bicikletë i ka dhënë kontribut aksidentit (sekondar).

Në bazë të ekspertizës mjekësore të ekspertit ortoped-traumatolog dr.M.H të datës 22.08.2020 vërtetohet se paditësja me rastin e aksidentimit ka pësuar thyerje të hundës, tronditje trunore, plagë prerëse - shtyese në buzën e sipërme majtas dhe në pjesën ansore të fytyres afër lapres së veshit të majtë, ndrydhje koke dhe fytyre, të shkaktuara nga goditja e mjetit të fortë dhe të mprehtë dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore, se është operuar dhe ka qëndruar në Klinikë, se në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjeksor, paditësja ka pasur këto dhimbje fizike me intenzitet posaqërisht të rëndë disa sekonda deri në humbje të vetëdijes, me intenzitet të rëndë 3 ditë dhimbje që manifestohen për shkak të fillimisht thyrjes së hundës, tronditjes trunore dhe plagëve në fytyrë, të cilat përcillen me dhimbje për kudër marrjes së terapisë kundër dhimbjeve, me intenzitet të mesëm 35 ditë, kohë e nevojshme për konsolidimin e indeve të cungelit në kofshën e majtë, periudhat e lidhjes së pastrimit, heqjes së pejëve, modelimit të cungelit etj, me intenzitet të ulë vazhdon edhe sot e kësaj dite, që paditësja e theksoi edhe gjatë ekzaminimit, se paditësja ka shëmtim trupor të shkallës së mesme, për shkak të vragës në buzën e sipërme të anës së majtë me gjatësi 3-4 cm dhe gjerësi 0.5 cm, pastaj vragës në pjesën anësore të fytyrës në anën e majtë afër lapres së veshit me gjatësi 7-8 cm dhe gjerësi 0.5 cm pas plagës prerëse- shtyese të cilat shihen tërë kohën. Se në dhënien e mendimit ka marrë parasysh edhe moshën e re dhe gjininë e paditëses si dhe veprimtarinë si instruktore fitnesi, se paditësja ka pësuar zvoglim të aktivitetit jetësor në shkallën 5.91%, për shkak të thyerjes së hundës dhe mbylljes së pjesërishme të njërës vrimë 3%, tronditjes trunore të verifikuar në kushte spitalore 3%, të gjitha këto të krahasuara me gjendjen e shëndoshë ku edhe pas operimit, mjekimit, si dhe procedurave rehabilituese, konsiston në pamundësinë e saj që ti kryej aktivitetet e mëparshme apo ti kryej me vështirësi të cilat i ka kryer para lëndimit pa vështirësi (aktivitete punuese), në masë të plotë, pastaj detyrat tjera jetësore, t’i plotësoj nevojat dhe dëshirat e saj në jetën private, kapitulli I pika 1.2.1 tronditja trunore e verifikuar në kushte spitalore (3%). Kapitulli II. Pika 2.3.3- Mbyllja e njërës vrimë të hundës (3%). Të llogaritura me formulën e Balthazarit, gjithsej = 5.91%, se vlerësimi i zvogëlimit të aktivitetit jetësor është përcaktuar në bazë të tabelave të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe BQK me dt.03.10.2016 duke shfrytëzuar Tabelat e Balthazarit, të përcaktuara në bazë të dispozitve të përgjithshme Kreu i III, neni 10, pika 5, se paditësja ka pas nevojë për ndihmen e personit të tretë - 35 ditë, që nënkupton ndihmën mjeksore profesionale dhe ndihmën jo profesionale nga antarët e familjes, ndihmë e ofruar për personin e

lënduar e cila i ka mundësuar plotësimin e nevojave elementare biologjike siç janë: veshja, zhveshja, higjiena personale, kryerja e nevojave të rregullta fiziologjike, lëvizja, kontrollat e rregullta specialistike, pasi këto nevoja nuk ka mundur ti plotësoj vet si rrjedhojë e pa aftësisë së plotë dhe të pjesshme të shkaktuar nga lëndimet, se paditësja ka pas nevojë për ushqim të përforcuar - 35 ditë, ushqim i pasuruar me proteina, minerale, vitamin, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit si dhe reaksionet post traumatike se paditësja ka pas nevojë për rehabilitim fiziatriko-psikik - 15 ditë, të cilat janë të nevojshme për përmirsimin e lëvizjeve në nyjen e qafës si dhe rritjen e forces dhe masës muskulore të dobësuar si pasojë e shtangimit të zhvilluar në qafë për shkak të pa mundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit.

Në bazë të ekspertizës së ekspertit të komunikacionit ing.S.B të datës 08.01.2021, vërtetohet se deri te aksidenti i komunikacionit ka ardhur si pasojë e asaj se automjeti “A” gjatë lëvizjes në vendbanim – ka lëvizur me shpejtësi të madhe dhe nuk ka pasur përqendrimin e duhur në ngasje, sipas analizave “hapsirë-kohë” ngasësi i automjetit “A” ka pasur mundësi ta përceptoj veprimin e biçikletës në distancë të mjaftueshme dhe ka pasur mundësi ta ngadalësoj mjetin, ngasësi “A” me shpejtësi të rrezikshme dhe nga pakujdesia ka vepruar duke e shkaktuar aksidentin, se ngasësi i automjetit “A” kur lëviz në rrugen kryesore, nëpër zonën urbane e cila rrugë ka shumë hyrje / dalje të këmbësoreve dhe biçikletave është i obliguar të rritë kujdesin në ngasje, të përshtatë shpejtësinë e lëvizjes, të jetë i gatshëm për rreziqet nga dalja e këmbësoreve dhe fëmijëve në atë zonë urbane të frekuentuar, por e ka neglizhuar rrezikun, mandej se ngasësja e biçikletës “B” ka filluar kalimin e rrugës në mënyrë të pakujdesshme, ngasësja e biçikletës duhet të ketë parasysh se biçikleta konsiderohet mjet në komunikacion dhe duhet ti respektoj rregullat e trafikut si gjitha mjetet tjera, në rastet e kalimit të rrugës tërthorazi këtë veprim mund ta bëj vetëm kur bindet për sigurin në komunikacion. Ka konstatuar se ngasësja e biçikletës (paditësja) “B” me veprimet e saj ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, ndërsa përfundimisht ka konstatuar se: drejtuesi i automjetit A). I.N Auto: FORD (BKS), është shkaktar i aksidentit (primar) kurse B). K.K (paditsja), me bicikletë, i ka dhënë kontribut aksidentit (sekondar).

Në bazë të raportit të epikrizes të lëshuar nga Spitali Amerikan në Prishtinë, me datën 28.09.2023 vërtetohet se paditësja është shtrirë për ndërhyrje kirurgjike në hundë, pranë këtij spitali me datën 27.09.2023 dhe ka dalë nga spitali me datën 28.09.2023. Në raport theksohet se pacientja-paditësja ka pasur fraktur të kockave të hundës nga aksidenti në komunikacion para 11 viteve dhe është përshkruar me diagnozen : Deff Pyramidis nasi, DSN St.post . fractura osium nasalium.

Nga fatura e lëshuar nga Spitali Amerikan në Prishtinë, me datën 27.09.2023 vërtetohet se paditësja si rrjedhojë e ndërhyrjes kirurgjike, si pasojë e aksidentit, ka shpenzuar për operim shumë prej 1,425 euro.

Gjykata në vështrim të nenit 7 dhe 8 të LPK-së, provat i vlerësoi një nga një dhe të gjitha së bashku dhe në bazë të rezultatit të përgjithshëm të procedurës, vërtetoi se kërkesëpadia e paditësës K.K pjesërisht është e bazuar.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të bazës juridike të kërkesëpadisë në këtë çështje juridike ka caktuar ekspertët e komunikacionit R.B dhe S.B.

Duke pas parasysh se ekspertiza e komunikacionit e ekspertit R.B nuk i ka sqaruar lëshimet e pjesëmarrësve në mënyrë të kjart, se paditësja a ka dhënë apo jo kontribut në shkaktimin e aksidentit, me propozimin e palës së paditures, në këtë çështje juridike është caktuar eksperti tjetër i komunikacionit S.B i cili në mendimin dhe konstatimin e tij e ka skjaruar faktin në mënyrë të kjart se ngasësja e biçikletës (paditësja) “B” me veprimet e saj ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, ndërsa përfundimisht ka konstatuar se: drejtuesi i automjetit A). I.N, auto: FORD (BKS), është shkaktar i aksidentit (primar) kurse B). K.K (paditsja), me bicikletë, i ka dhënë kontribut aksidentit (sekondar).

Gjykata ia fali besimin e plotë ekspertizës së ekspertit S.B pasi që i njëjti e ka ndarë kuart konstruktiv dhe secilës palë në shkaktimin e aksidentit dhe pasi që ekspertiza e tij ishte bindëse dhe në lidhmëri me provat tjera respektivisht ekspertiza e komunikacionit nuk është kundërshtuar me prova konkrete nga e pala paditëse apo pala e paditur pra nuk kishin vërejtje apo ndonjë propozim për plotësimin e kësaj ekspertize apo nxirrjen e një ekspertize tjetër të komunikacionit. Palët nuk kanë kërkuar që të ftohet eksperti S.B për dhënie të sqarimeve të ndryshme e gjithashtu edhe për gjykatën ishte e kuart , e pranueshme dhe bindëse.

E paditura gjatë procedurës nuk e ka kontestuar plotësisht bazën juridike të kërkesëpadisë me arsyetimin se përgjegjësia ndarë e të paditësës me paditësen në shkaktimin e aksidentit duhet të ndahet me 70% për të paditësen kurse 30 % për paditësen, kurse pala paditëse pretendonte se e paditura bart përgjegjësi me 80% kurse paditësja me 20%, ndërsa që të dy palët ndërgjyqëse nuk kishin vërejtje në ekspertizën e ekspertit S.B.

Për të vërtetuar lartësinë e kërkesëpadisë së paditësës, gjykata në këtë çështje juridike ka nxjerr ekspertizën e ekspertëve mjekësor ortoped – traumatolog dr.A.Xh dhe ekspertit mjekësor ortoped – traumatolog dr.M.H.

Duke pas parasysh se në dy ekspertizat e lartcekura të ekspertëve mjekësor ortoped dhe traumatolog të lartcekur, ishte theksuar se paditësja ka pasur ndër të tjera thyerje të hundës - (fractura) dhe për palën paditëse ishte i pa kuptueshëm mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjekësor dr.A.Xh se paditësja ka pësuar vetëm lëndime të lehta trupore, me propozimin e palës paditëse në rigjykim, gjykata ka nxjerrë ekspertizë të re mjekësore nga lëmia e ortopedisë dhe traumatologjisë përmes ekspertit dr.M.H të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që e njëjta e ka shkjaruar mënyrë bindëse dhe në lidhmëri me provat tjera respektivisht ekspertiza nuk është kundërshtuar me prova tjera konkrete nga e pala paditëse apo pala e paditur pra nuk kishte ndonjë propozim për plotësimin e kësaj ekspertize apo nxirrjen e një ekspertize tjetër mjekësore. Eksperti ka prezentuar edhe në seancën e datës 02.11.2020 në të cilën seancë ka dhënë sqarime në pyetje të të paditësës.

Për gjykatën kjo ekspertizë ishte e mjaft e kuart, e pranueshme dhe bindëse ndërsa ekspertizës së ekspertit dr.A.Xh nuk i dha besimin për shkak se mendimi dhe konstatimi i ekspertit të tillë ishte kontradiktor me vetveten dhe nuk ishte bindës.

Sa i përket frikës së përjetuar nga paditësja në aksidentin e komunikacionit, eksperti psikiatër ka ardh në përfundim se paditësja si pasojë e aksidentit ka përjetuar frikë si më lart cekur, të cilës gjykata ia fali besimin e plotë pasi që i njëjti e ka shkjaruar mënyrë bindëse dhe në lidhmëri me provat tjera respektivisht ekspertiza psikiatrike nuk është kundërshtuar me prova tjera konkrete nga e pala paditëse apo pala e paditur pra nuk kishte ndonjë propozim për plotësimin e kësaj ekspertize apo nxirrjen e një ekspertize tjetër mjekësore. Eksperti ka ardhur në këtë përfundim pas vrojtimit të drejtëpërdrejtë të paditësës në gjykatore dhe bazuar edhe në provat në shkresat e lëndës.

Ekspertiza e ekspertit psikiatër të lartpërmendur, përmbante elementet e nevojshme të dhënë mbi bazën e njohurive profesionale dhe arsyeve të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Andaj në bazë të provave të administruara mjekësore, për dhimbje fizike, paditësës gjykata i ka caktuar shpërblimin në shumën prej 2800 euro, duke vlerësuar si shpërblim të drejt që i shërben qëllimit të kompensimit të dëmit sepse paditësja sipas mendimit të ekspertit ortoped të mjekësisë dr.M.H si pasojë e aksidentit, ka pësuar lëndimet të rënda trupore, të lartcekura, të klasifikuara si lëndime të rënda trupore, ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se shuma e aprovuar është plotësisht në harmoni edhe me praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës, ndërsa mbi shumën e gjykuar prej 700 euro, gjykata e refuzoi duke e konsideruar si kërkesë të lart dhe jo në proporcion me natyrën e lëndimit trupor që i ka pësuar paditësja në këtë aksident të komunikacionit duke marrë parasysh kontributin sekondar të paditësës në shkaktimin e dëmit.

Për frikën e përjetuar nga paditësja në aksidentin e komunikacionit, gjykata ka caktuar shpërblimin në shumën prej 2400 euro, duke pasur parasysh intensitetin dhe kohëzgjatjen e frikës së lartcekur sipas ekspertizes mjekësore, ashtu që gjykata ka ardhur në përfundim se shumtë caktuara janë plotësisht në harmoni edhe me praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës, ndërsa mbi shumtë e gjykuara, në lartësi prej 600 euro, gjykata i refuzoi duke i konsideruar se janë shumë të larta dhe jo në proporcion me natyrën dhe kohëzgjatjen e frikës së përjetuar që ka përjetuar paditësja në këtë aksident të komunikacionit dhe kontributin e paditësës në shkaktimin e dëmit.

Për dhimbje shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor prej 5.91 % paditësës gjykata ia ka aprovuar shumtë prej 2800 euro, ndërsa mbi shumtë e gjykuara, në lartësi prej 700 euro, gjykata ia refuzoi duke e konsideruar se janë shumë të larta dhe jo në proporcion me natyrën zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, duke marrë parasysh kontributin e paditësës në shkaktimin e dëmit.

Në emër të shëmtimit trupor, gjykata i'a ka aprovuar shumtë prej 2400 euro, duke pas parasysh shkallën e shëmtimit trupor të lartcekur, ndërsa mbi shumtë e gjykuara, në lartësi prej 600 euro, gjykata ia refuzoi duke e konsideruar se janë shumë të larta dhe jo në proporcion me natyrën e shëmtimit trupor duke marrë parasysh kontributin e paditësës në shkaktimin e dëmit.

Sa i përket shpenzimeve të ushqimit të përforcuar gjykata i'a ka aprovuar shumtë prej 245 euro, duke pas parasysh nevojën e paditësës për ushqim të përforcuar për shkak të lëndimeve të saj trupore, ndërsa mbi shumtë e gjykuar, në lartësi prej 105 euro, gjykata ia refuzoi në proporcion me kontributin e paditësës në shkaktimin e dëmit dhe duke u bazuar në praktiken gjyqësore.

Në emër të kujdesit dhe ndihmës nga personi tjetër, paditësës gjykata i'a ka aprovuar shumtë prej 280 euro, duke pas parasysh kohëzgjatjen e kësaj nevojë të lartcekur, ndërsa mbi shumtë e gjykuara, në lartësi prej 70 euro, gjykata ia refuzoi duke e konsideruar se janë shumë të larta dhe jo në proporcion me kohëzgjatjen e kësaj kategorie të kërkesës.

Në emër të shpenzimeve të mjekimit të paditësës, gjykata i'a ka aprovuar shumtë prej 1200 euro, duke pas parasysh se paditësja ka dorëzuar si provë fakturen e lëshuar nga Spitali Amerikan në Prishtinë, me datën 27.09.2023 nga e cila vërtetohet se paditësja si rrjedhojë e ndërhyrjes kirurgjike, si pasojë e aksidentit, ka shpenzuar për operim shumtë prej 1,425 euro, ndërsa mbi shumtë e gjykuar, në lartësi prej 300 euro, gjykata ia refuzoi në proporcion me kontributin e paditësës në shkaktimin e dëmit. Këto shpenzime kishin lidhje kauzale me aksidentin dhe lëndimet e pësura të paditësës nga aksidenti pasi që përveq që përshkruhen në raportin e epikrizes së lëshuar nga Spitali Amerikan edhe eksperti ortoped në ekspertizen e tij ka theksuar se paditësja ka pësuar lëndimet – thyerjen në hundë për qka edhe paditësja është operuar dhe ka kryer ndërhyrje kirurgjike dhe i janë krijuar shpenzime të dokumentuara me faturë.

Gjykata e refuzoj në tërësi pjesën e kërkesëpadisë së paditësës që ka të bëjë kërkesën për rehabilitim, në mungesë të provave sepse paditësja me asnjë provë shkresore nuk i ka argumentuar pretendimet e saj në këtë pjesë të kërkesëpadisë se ka qenë respektivisht ka shpenzuar për rehabilitim, si pasojë e aksidentit lëndor, prandaj në mungesë të provave dhe duke u bazuar në nenin 319 të LPK-së, gjykata për këtë pjesë të kërkesëpadisë vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, gjykata, vlerëson se shumtë e aprovuara në emër të shpërblimit të dëmit për paditësen, paraqesin shpërblim real dhe të drejtë që paditësja me këto mjete ti plotësojnë nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara që përndryshe nuk paraqesin shpërblim absolut të dëmit që i është shkaktuar.

Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata vlerësoi se e paditura mban pjesërisht përgjegjësinë në bazë të fajit për dëmin që i është shkaktuar paditëses, me rastin e lëndimeve gjatë aksidentit të trafikut për çka e paditura është e obliguar që paditësit t'ia kompensoj dëmin meqenëse shkaktuesi i dëmit nuk ka qenë i siguarur dhe në këto rrethana kompensimin e dëmit e bënë tani e paditura.

Gjykata gjeti se e paditura mban përgjegjësinë për dëmshpërblimin e paditëses, bazuar në nenin 18 par 1 të Ligjit nr.04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia ku përcaktohet se:“Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit, nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësisë, ka të drejtë të kërkoj dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja”.

Duke duke marrë parasysh natyrën dhe shkallën e dëmtimeve trupore të shkaktuara paditëses, në bazë të vlerësimit të ekspertizës mjekësore të ekspertit ortoped dr.M.H, të përshkruara si më lart, gjykata e aprovoi pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar e në vlerën e shpërblimit të dëmit si në pikën I, të dispozitivit të aktgjykimit, me kamatë ligjore, sic u cek me lart, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit nga e paditura.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me demin material dhe jo material, gjykata vendosi si në të dispozitiv të aktgjykimit, pasi që vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë.

Gjykata konsideron se shuma e gjykuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraqesin një satisfakcion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar të paditësit në aksidentin e komunikacionit, lëndimeve dhe pasojave bazuar në dispozitën e nenit 154, 178, 192, 200 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (i vjetër), standardin jetësor të qytetarëve të Kosovës dhe praktiken e deritanishme të Gjykatave të Kosovës.

Gjykata vlerëson se pretendimi i të paditës se me lejimin e ndryshimit të padisë në aspektin objektiv, gjykata ka tejkalar kërkesëpadinë e paditëses nuk qëndrojnë, pasi që gjykata ka vendosur bazuar në kërkesën e precizuar të paditëses dhe fakteve të vertetuara në këtë çështje kontestimore, pas lejimit të ndryshimit në aspektiv objektiv.

Gjykata, përveç çështjes kryesore në këtë rast aprovojë edhe kërkesën e paditësit lidhur me kamatëvonesën ashtu që e paditura obligohet të paguan lartësinë e kamatës si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 277 të LMD-së (së vjetër) dhe Mendimin Juridik për Kamatën me nr. 265/2020 i datës 02.12.2020, i dhënë nga Gjykata Supreme e Kosovës, si në pikën I, e lidhur me piken IV, sepse kamaten paditësja e ka kërkuar nga data 12.06.2015 e gjerë në pagesën definitive dita kur është lëshuar aktgjykimi i parë në këtë çështje kontestimore, andaj edhe u vendos si vendos në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës vendosi në bazë të nenit 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Kërkesa e palës paditëse për kompensimin e shprnezimeve procedurale ishte në shumë prej 2538 euro.

Gjykata ia njohu palës paditëse shpenzimet për: përpilimin e padisë ne shume prej 104 euro, për ekspert psikiatër dhe ortoped shumë prej 200 euro, për ekspertizë të dytë ortope shumë prej 150 euro, për ekspertizë të komunikacionit shumen prej 100 euro, taksë gjyqësore 25 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 20.04.2015 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 06.05.2015 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 01.06.2015 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 01.07.2020 shumë prej 270 euro, për përfaqësim në seancën e shtyrë gjyqësore të datës 03.08.2020 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 03.11.2020 shumë prej 270 euro, për përfaqësim në seancën e shtyrë gjyqësore të datës 09.11.2020 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën e shtyrë gjyqësore të datës 09.12.2020 shumë prej 135 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 05.01.2021 shumë prej 270 euro, për

përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 04.02.2021 shumën prej 270 euro, për përfaqësim në seancën gjyqësore të datës 14.03.2024 shumën prej 270 euro, për precizim të kërkesëpadisë shumën prej 204 euro, por duke pasur parasysh suksesin në procedurë të palës paditëse, gjykata ia njohu vetëm shumën prej 2030,40 euro, 80 % të shpenzimeve të krijuara, e të cilat shpenzime procedurale e paditura duhen t'ia paguaj paditëses si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm Divizioni Civil
C.nr.353/24, datë: 22.03.202

Gjyqtari Izet Gërguri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta e ankesës në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit e Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.